

VENDIM
Nr. 271, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË MENAXHIMIT, OPERIMIT, MIRËMBAJTJES DHE PËRMIRËSIMIT TEKNIK TË
TERMINALIT TË TRAGETEVE NË PORTIN E DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1 e 3, e 16 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të trageteve në Portin e Durrësit është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Koncesioni do të jetë një koncesion shërbimi si propozim i kërkuar i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha